



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2020

V E N D I M

Nr. 72, Datë 17/07/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 63, datë 30.06.2020, e Z. M.M., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga ana Shoqërisë “Alterum”, ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “për çdo shkak tjetër”, nga ana e z. E.F. dhe personit juridik “Ejon Media Grup”.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit të dërguar nga përfaqësuesit ligjorë të ankuesit M.M., i cili është rezident në Bullgari, pretendohet se ankuesi është vënë prej kohësh në shënjestër të medias elektronike Ejon Media Grup sh.p.k., e njohur ndryshe me emrin e saj mediatik “City News Albania” (CNA.al). Botuesi i këtij portali, z. E.F., nëpërmjet shkrimeve të tij, të vazhdueshme pretendohet se ka cënuar rëndë reputacionin e z. M.M. dhe të familjes së tij, duke i atribuar fakte të paqena, të pavërteta dhe tërësisht të sajara, duke i krijuar shqetësime personale dhe familjare.

Subjekti Ejon Media Grup sh.p.k. ka publikuar shkrimet e mëposhtëme:

1. Skandali 60 mln USD në Zimbabve zbulon fytyrën e K. M., njërit-hije të inceneratorëve. Ky shkrim pa emër gazetari është shkrim editorial i portalit City News Albania, i datës 13.06.2020;
2. Afera 60 mln USD, arrestohet përfaqësuesi i K.M., hetim edhe nga Interpol Budapest. Shkrim editorial i portalit City News Albania, i datës 14.06.2020;
3. “Skandali 60 mln USD në Zimbabve. Si u përfshi K. M. në dy tenderat korruptivë. Editorial i portalit City News Albania i datës 16.06.2020;
4. Mashtrimi 60 mln USD/Klodia M. M. i inceneratorëve “në shënjestër” të autoriteteve ndërkombëtare: Editorial i portalit City News Albania, i datës 17.06.2020
5. Skandali i tenderave të Klodian M.M. Arrestohet Ministri i Shëndetësisë në Zimbabve. Editorial i portalit City News Albania, i datës 20.06.2020.

Në këto shkrime, z. E.F. në cilësinë e botuesit dhe ortakut të portalit City News Albania aludon se ankuesi M.M., në vitin 2019 dhe 2020 është prezantuar pranë autoriteteve të Zimbabvesë si z. I. D., pronar i kompanisë “Drax Consult SAGL”, me qendër në Zvicër, si dhe ka negociuar e lidhur një kontratë me qeverinë e atij shteti, në emër të Kompanisë “Drax Consult SAGL”, për furnizimin e Ministrisë së Shëndetësisë së Zimbabvesë me ilace dhe material anti Covid, me një vlerë 60 milion dollarë.

Në ankesë theksohet fakti se e gjithë përmbajtja e shkrimeve ka fakte tërësisht të rreme që nuk kanë lidhje me z. M.M., por që kanë patur si synim denigrimin e figurës së tij dhe të familjes së tij, duke cënuar rëndë nderin dhe dinjitetin e tij. Në këtë kontest, në ankesë pretendohet diskriminim në formën e shqetësimit, për shkak të gjendjes ekonomike të ankuesit.

A. Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 63, datë 30.06.2020, e Z. M.M., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga ana e Shoqërisë “Alterum”, Komisioneri konstatoi se:

Në faqen City News Albania janë publikuar disa shkrime, subjekt i së cilëve është ankuesi M.M.. Disa pjesë të këtyre shkrimeve pasqyrohen si më poshtë vijojnë:

1. Skandali 60 mln USD në Zimbabve zbulon fytyrën e Klodian M.M.t, njërit-hije të inceneratorëve, i datës 13.06.2020;

Në këtë artikull është publikuar një foto me pesë persona, si dhe është shkruajtur si më poshtë vijon:

“Qeveria e Zimbabvesë ka urdhëruar anulimin e një tenderi 60 milionë USD që agjensia shtetërore shëndetësore, “Natpharm” kishte lidhur me kompaninë “Drax International” të biznesmenit shqiptar I. D., nën dyshime për afëra korruptive. Skandali, i cili po zhvillohet prej 2 muajsh në vendin afrikan, zbulon për herë të parë edhe fytyrën e “njeriut-hije” të inceneratorëve në Shqipëri, Klodian (alias Mirel) M.M.. M.M., i cili njihet vetëm si emër, që qendron pas inceneratorëve në pronësi formale të K. Z., është paraqitur në Zimbabve me emrin I. D. Agjensia e lajmeve “Zimlive”, e cila ka raportuar më herët për skandalin e ilaceve, ka publikuar një foto të zyrtarëve të lartë të këtij vendi, me biznesmenin shqiptar I. D. (K. M.) dhe ish-deputetin e Partisë Demokratike, G.B.....Anulimi i tenderit, sipas “Zimlive” vjen pas disa raportimeve mediatike vendase zbuluan se kontrata për pajisje mjekësore dhe medikamente ishte nënshkruar me kompaninë e shqiptarit, e cila nuk rezultonte e regjistruar në regjistrin përkatës shtetëror.....”

2. Afëra 60 mln USD, arrestohet përfaqësuesi i Klodian M.M.t, hetim edhe nga Interpol Budapest. Shkrim editorial i portalit City News Albania, i datës 14.06.2020;

“.... Biznesmenit kontravers K. (alias M.) M.M., i konsideruar “njeriu hije” i inceneratorëve të përpunimit të mbetjeve, i ka shkuar çdo gjë vaj, pavarësisht dyshimeve për afëra korruptive. Por, M.M., duket se po përballët me probleme serioze në një vend që pakkush në vendin tonë mendon se ka një shtet funksional në Zimbabve, një vend në qendër të Afrikës, ku biznesmeni prezantohet me emrin I. D. Përfaqësuesi i kompanisë së tij, D. N, një biznesmen nga Zimbabvja, i dënuar më parë për pastrim parash, është arrestuar së fundmi, në vijim të hetimeve të nisura për tenderin 60 milion euro të fituar nga “Drax SAGL” e K. M., për furnizimin me aparatura mjekësore dhe medikamente kundër Covid 19. BoldNews ka raportuar edhe më parë për këtë skandal financiar që ka shpërthyer në Zimbabve e që përfshin kompaninë “Drax SAGL” të I. D. (K. M.), si dhe familjarë të Presidentit të atij vendi, E. M. Raportimi i mëhershëm shoqërohej edhe me një foto, në të cilën dallohej presidenti Mnangagwa, nën shoqërinë e K. M.t, që atje prezantohet me emrin I. D.....Autoritetet e Zimbabves njoftojnë se kanë arrestuar në fundjavë përfaqësuesin vendor të K.M., D. N.. Biznesmeni afrikan dyshohet se është përfshirë në një skemë për përfitime të parregullta në tenderat për aparatura mjekësore dhe medikamente kundër Covid-19, për llogari të kompanisë “Drax International” të atij që në Zimbabve njihet si I. D.....Interpoli i Budapestit i shkruan Policisë së Zimbabves në kërkesën e datës 29 prill 2020: “Këto kompani (në pronësi të I. D.-alias K.M.) mund të jenë të lidhura me të tjera kompani që janë subjekte të hetimit kriminal./ BoldNews”.

3. “Skandali 60 mln USD në Zimbabve. Si u përfshi Klodian M.M. në dy tenderat korruptivë. Editorial i portalit City News Albania i datës 16.06.2020;

“Agjensia e lajmeve ka publikuar edhe dokumentet e siguruara nga Interpol dhe policia Zimbabvean, të cilat konfirmojnë se transaksionet po hetohen si një “krim”. Në qendër të skemës miliona dollarëshe nga Zimbabve është biznesmeni I. D., i identifikuar nga Zimlive si K.M. (M.M.), i cili ka udhëtuar për në Zimbabve për t’u takuar me Mnangagwa dhe partnerin e tij në Zimbabve, D. N. Sipas Interpolit, ai zotëronte disa kompani që më vonë mbyllnin dyqanet. “Këto kompani mund të jenë të lidhura me kompani të tjera që kanë qenë subjekt i një hetimi penal thuhet në letrën e zyrës së 29 prillit të Interpol Budapest drejtuar Policisë së Republikës së Zimbabve (ZRP), duke kërkuar më shumë informacion mbi pagesën prej 2 milion dollarësh. Në artikull thuhet se ekzistojnë prova që vërtetojnë se I.D është aksioneri i vetëm në dy kompanitë zviceriane – Drax Consult SAGL dhe 3-DD Swiss Trading. Vetëm 2 javë pasi regjistroi degën e Drax Consult SAGL në Hungari, llogaria bankare e kompanisë së re u kreditua me 2 milion dollar amerikanë. Organizata Ndërkombëtare e Policisë ka filluar një hetim për pastrim parash në bashkëpunim me autoritetet në Hungari dhe Zimbabve.....”

4. Mashtrimi 60 mln USD/Klodian M.M. i inceneratorëve “në shënjestër” të autoriteteve ndërkombëtare: Editorial i portalit City News Albania, i datës 17.06.2020.

“Biznesmeni afrikan D. N. do të qendrojë në burg, ndërkohë që autoritetet e Zimbabves po hetojnë shqiptarin Klodian (Mirel) M.M., i prezantuar atje me emrin I. D., pronar i kompanisë së këshillimit, “Drax Consult SAGL”, e cila fitoi në mënyrë të dyshimtë një tender 60 milionë dollarë për furnizimin me pajisje anti – Covid. Një gjykatës në kryeqytetin e Zimbabves, Hararë, refuzoi kërkesën e Ngujvas për lirim me kusht. Sipas Bold News, autoritetet në Zimbabve janë të bindur se kompania “Drax” e I. D. ose sic njihet në Shqipëri K. (alias M.) M.M., njeriu hije i inceneratorëve, ka mashtruar shoqërinë shtetërore të shëndetësisë, “Natpharm”, në tenderin për furnizim 60 milionë dollarë për pajisje mjekësore...Prokurorët thonë se kompania e I. D. (K.M.) hyri në marrëdhënie me shtetin “përmes mashtrimit”.

5. Skandali i tenderave të K M.M.t. Arrestohet Ministri i Shëndetësisë në Zimbabve. Editorial i portalit City News Albania, i datës 20.06.2020.

“Ditën e djeshme është arrestuar ministri i Shëndetësisë së Zimbabvesë, O. M., pas skandalit të dy tenderave, ku janë përfshirë edhe ish deputeti i partisë Demokratike G.B. dhe njeriu hije i koncensionit të inceneratorëve, për të cilin media “Zimlive” shkruan se është prezantuar në Afrikë si I. D. Kujtojmë se në qendër të skemës miliona dollarëshe në Zimbabve është biznesmeni I.D. Për këtë skandal është arrestuar edhe përfaqësuesi vendor i M.M., D. N., i cili dyshohet se ka shfrytëzuar lidhjet e tij me K. M., djalin e Presidentit E. M., për të fituar në mënyrë të

dyshimtë tenderin. Sipas raportimit të medias “Zimlive”, autoritetet në Hungari janë duke vazhduar hetimin e pastrimit të parave për kompaninë e M.M., e cila rreth dy javë më parë mori një pagesë të madhe prej 2 milion dollarësh nga qeveria e Zimbabwe.....”.

Pas analizimit të përmbajtjes së artikujve të mësipërm të publikuar në faqen City News Albania, të cilët ishin mbështetur kryesisht në media të tjera si Zimlive dhe BoldNews, Komisioneri gjykon si më poshtë vijon:

1. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (LMD) ofron mbrojtje nga diskriminimi ndaj të gjithë personave fizikë/juridikë, duke parashikuar një listë jo shterruese shkaqesh.

Në nenin 1 të tij parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në nenin 3, pika 1 të LMD, parashikohet se: *“1. “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Në referim të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, vërehet se pretendimet e tij janë bazuar në faktin se e gjithë përmbajtja e shkrimeve të sipërcituara ka fakte tërësisht të rreme, që nuk kanë lidhje me të, por që kanë patur si synim denigrimin e figurës së tij dhe të familjes së tij, duke cënuar rëndë nderin dhe dinjitetin e tij.

Referuar për sa më sipër Komisioneri vlerëson se përhapja e qëllimshme e informacioneve të rreme apo shpifja parashikohet si vepër penale në nenin 120 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.

Në nenin 120 parashikohet se: *“Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cënojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo*

vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë”.

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket “shpifjes” nga ana e z. E.F. dhe personit juridik “Ejon Media Grup”, Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjithashtu, referuar praktikës së ndjekur nga KMD, “*shqetësimi*”¹ lidhet me përdorimin e gjuhës, denigruese, poshtëruese, stereotipizuese, diskriminuese apo stigmatizuese kundrejt një personi apo grupi personash të identifikuar me një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Gjithashtu, nisur nga kjo praktikë, diskriminimi në formën e shqetësimit që lidhet me gjuhën e urrejtjes të përdorur publikisht, është vlerësuar nga e institucionit të KMD-së në rastet kur përdorimi i saj prek një komunitet personash që kanë karakteristika të përbashkëta dhe identifikohen me një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të LMD.

Bazuar në nenin 33, pika 4, të Ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt.”*

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni

¹ Në nenin 3/5 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *““Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë”.*

33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe për rrjedhojë ankesa nuk pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 7, 12-13, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 63, datë 30.06.2020, e z. M.M., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga ana Shoqërisë “Alterum”.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER

Shkak – gjendja ekonomike, cdo shkak tjetër
Fusha – të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit - mospranim